



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ .01.2025

Lënda: Përgjigje kërkesës së paraqitur nga znj. A.K.

Adresa: _____

E-mail :

TIRANË

E nderuar znj. K.!

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, nr. shkresën nr. 25 prot., datë 08.01.2025 tonën), lidhur me shtetasin I.B. për periudhën para vitit 1991, për veprimtarinë e tij në raport me ish Sigurimin e Shtetit si edhe gjatë periudhës që ka drejtuar Gj. e K. e jo vetëm, si edhe për proceset ku janë dënuar në mënyrë të padrejtë disa personave (10 gjithsej) me emrat përkatës e ku z. I.B., ka ushtruar detyrën si gjyqtar përpara viteve 1991, dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, me anë të së cilës në referencë të nenit 3 dhe 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar, sipas informacionit të dërguar nga struktura përgjegjëse që trajton sipas ligjit nr. 45/2015, ju informojmë si më poshtë:

1. Pranë Autoritetit, është depozituar kërkesa me nr. 1792 prot., datë 25.10.2024 e paraqitur nga shtetasi I.B. në cilësinë e të prekurit. Qëllimi i kërkesës është marrje e informacionit nëse I.B. ka qenë ndonjëherë iurvejuar dhe nëse ka dokumente për të në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit, për të vërtetuar që nuk ka qenë bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit dhe që nuk ka qenë i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit.

Kërkesa është legjitimuar në mbledhjen e datës 08.11.2024. Aktualisht po punohet me praktikën dhe nuk ka kaluar ende për vendimarrje në Autoritet. Në përfundim të procesit do të publikohet vendimi i shkurtuar përkatës në faqen e institucionit dhe do t’ju përcillet një përgjigje zyrtare.

Sa i takon personave të dënuar rezulton si më poshtë:

Për z. S.K., është marrë nga Autoriteti Vendimi nr. 468 dt. 18.09.2020

Për z. V.Ç., është marrë nga Autoriteti Vendimi nr. 414 dt. 25.06.2019

Për z. F.P., është marrë nga Autoriteti Vendimi nr. 517 dt. 02.09.2024

Kërkuesve ju janë vendosur në dispozicion bashkë me Vendimet përkatëse informacionet e identifikuar.

Këto vendime ju mund ti gjeni të publikuara edhe në faqen zyrtare të Autoritetit në buletinët respektivë.

Për sqarime të tjera sipas objektit të kërkesës tuaj Autoriteti do t’ju informojë nga strukturat përkatëse për procedurën që duhet të ndiqni për garantimin e të drejtës për informim në zbatim të ligjit nr. 45/2015 si ligj që prevalon në rastin konkret mbi ligjin nr. 119/2014 i ndryshuar.

Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit

L. Cocoli

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Sofi Noti